



Datë: 28.04.2025
Numër Protokolli: 3595/2025

A.nr.460/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.460/2025, të datës 13.03.2025, të parashtruar nga ankuesja A.A kundër organit të punësimit/Komunës së Obiliqit, në çështjen juridike “*vlerësimi rezultateve në punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 29.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.460/2025, e datës 13.03.2025, e parashtruar nga ankuesja A.A.

II. Anulohet Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen i datës 27.02.2025, dhe çështje kthehet në *rishqyrtim dhe rivendosje*.

III. Obligohet Udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit, në Komunën e Obiliqit, që në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankueses të bëjë rivlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh.

IV. Obligohet Kryetari i Komunës së Obiliqit, të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi sikurse përcaktohet në pikën III, të dispozitivit.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra në zbatim të këtij vendimi.

Ar sy e t i m

Nëpunësja civile, A.A(tutje referuar vetëm ankuesja), më datë 13.03.2025, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Formularit të datës 27.02.2025, lidhur më vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2024.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.03.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Obiliqit, ndërsa, kjo e fundit, më datë 25.03.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1640/2025 të datës 13.03.2025, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 27.02.2025; Njoftimin e datës 12.03.2025 nga ankuesja për L. E dhe A.M; Vendimin me numër protokolli 02/30-05-26046-24 të datës 09.09.2024; Emailin e datës 01.03.2024, 26.02.2024, 22.02.2024 nga ankuesja për L.E; Emailin e datës 28.02.2024, 23.02.2024, 22.02.2024 nga L.E për ankuesen; Aktgjykimin A.nr.2027/2023 i datës 27.02.2025 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Vendimin A.nr.642/2023 të datës 09.06.2023 të KPMSHCK-së; Vendimin A.nr.762/2023 të datës 12.07.2023 të KPMSHCK-së; Vendimin A.nr.331/2023 të datës 31.03.2023 të KPMSHCK-së; Vendimin A.nr.663/2022 të datës 22.09.2022 të KPMSHCK-së; Kopjen e ID-së së ankueses; Emailin e ankueses për ankesa.kpmschck@rks-gov.net; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 19.03.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 25.03.2025; Akt Emërimit e datës 01.06.2015; Emailin e datës 03.03.2025 nga ankuesja për L.E; Raportin mjekësor i lëshuar nga Spitali Fati Im në emër të ankueses; Vendimin me numër protokolli 02-020-01-7050/25 i datës 13.03.2025; Shkresën e datës 24.03.2025 nga mbikëqyrësja e ankueses; Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 11.04.2024; Njoftim për kontratën e datës 30.04.2024; Njoftim për kontratë datë 03.04.2024; Kërkesë për rishqyrtim lidhur me tenderin e Renovimit të SHFMU Dr.Ibrahim Rugova; Vendim i datës 07.05.2024; Njoftim për kontratë e datës 17.05.2024; Njoftim për kontratë e datës 06.06.2024; Vendimin A.nr.1116/2023 të KPMSHCK-së; Vendimin e datës 22.04.2025 për shtyrjen e afatit për vendosje të ankesës së ankueses.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankueses, është e bazuar, **dhe së çështja duhet të kthehet në shqyrtim, sepse:**

Nga provat e administruara rrjedhë së ankuesja sipas Akt Emërimit me numër protokolli II-113 të datës 01.06.2015, mbanë pozitën e punës *Zyrtar i Lartë i Prokurimit*, në Komunën e Obiliqit.

Tutje sipas shkresave të lëndës rezulton se mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e ankueses më datë 27.02.2025 ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2024 dhe të njëjtën e ka vlerësuar sipas nivelit të vlerësimit “*Ka nevojë për përmirësim*”.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon se lidhur me objektivin e parë vlerësimi është bërë pa një mbështetje në fakte konkrete pasi që dosjes që unë kam përgatitur janë trajtuar dhe pranuar pa asnjë refuzim nga autoritetet mbikëqyrëse, lidhur me objektivin e dytë pretendon se vlerësimi i këtij objektivi nuk pasqyron realitetin pasi që jam e angazhuar dhe kam qenë në koordinim me njësinë kërkuese; lidhur me objektivin e pestë vlerësimi nuk përkon me realitetin sepse të gjitha detyrat i kam përfunduar nga mbikëqyrësja që me janë deleguar. Kam përmbushur detyrat dhe nuk kam pasur asnjë vërejtjet për mos përmbushje të detyrave të punës. Kërkon që ankesa të aprovohet të shfuqizohet vlerësimi dhe të bëhet rivlerësimi.

Fillimisht Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmërinë e ankueses së ankueses, konstaton se e njëjta është e lejueshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 17 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, dhe e njëjta është e pranueshme në kuptim të nenit 127 paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore Kolegji i Këshillit, ju referuar Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë nenit 52, me të cilin është përcaktuar se: *1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i vazhdueshëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuara, vlerësimin e aftësisë profesionale, metodologjike, personale dhe sociale të nëpunëses/it civil në realizimin e objektivave dhe përmbushjen e përgjithshme të përgjegjësisë të njësisë. 2. Periudha e vlerësimit zgjat një (1) vit, nga 1 janari deri me 31 dhjetor. Procedura e dhënies së vlerësimit përfundon deri më 28 shkurt të vitit pasues. 3. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në: 3.1. realizimin e objektivave të përcaktuara në planin vjetor individual, përmbushjen e detyrave të punës në përputhje me përshkrimin përkatës të punës, objektivat e njësisë dhe institucionit, si dhe kryerjen e detyrave të atypëratyshme që nuk janë paracaktuar paraprakisht apo nuk kanë mundur të paracaktohen; 3.2. aftësitë profesionale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe sjelljen profesionale; 3.3. aftësitë metodologjike, personale dhe sociale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës. 4. Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunëses/it civil bëhet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësen/in dhe përfaqësuesen/in e njësisë së burimeve njerëzore, me shkrim, në muajin janar të çdo viti, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave. 5. Plani individual i punës i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni, mund të rishikohet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me nëpunësen/in civil. 6. Procedura e vlerësimit të rezultateve në punë përfshin dy (2) faza kryesore: 6.1. mbikëqyrjen e vazhdueshme të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë; 6.2. vlerësimin vjetor të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore. 7. Performanca e nëpunëses/it civil të kategorisë profesionale dhe kategorisë së specialistes/it vlerësohet nga mbikëqyrësja/ie saj/tij i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore. 8..10. Përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, merr pjesë, mbështet dhe vëzhgon çdo proces të vlerësimit. 11. Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë gjatë procesit të vlerësimit është e/i obliguar të vlerësojë nëpunësen/in në mënyrë objektive dhe të argumentojë vlerësimin. 12. Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore zhvillojnë takim me nëpunësen/in për vlerësimin e rezultateve të punës. Pas takimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë aprovon formularin e vlerësimit që e nënshkruajnë të gjitha palët”.*

Rrjedhimisht në kuptim të kuadrit ligjor si më lartë, e mbi bazën e analizimit të aktit të kontestuar Kolegji ka gjetur se ankuesi lidhur me objektiven nr. 1: *Bënë përgatitjen e fletëporosive, kuotimin e çmimeve, tenderëve, reklamave, specifikimeve, et, Hulumton tregun, përgatit kërkesat për oferta të çmimeve dhe për prokurimin në pajtim me rregulloret në fuqi për mënyrat e prokurimit*” është vlerësuar më “*ka nevojë për përmirësim*”, por sipas provave të lëndës të dërguar çoftë nga ankuesja por edhe nga organi përkatës i punësimit, Kolegji i Këshillit, konstaton se edhe përkundër faktit që mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e ankueses ka pretenduar që ankuesja gjatë tërë vitit bënte gabime në procedura, sipas provave të lëndës del vetëm komunikimet e ndodhura lidhur me dosjen e tenderit për sinjalizim horizontal dhe vertikal që janë të muajit shkurt 2024 dhe një e datës 01.03.2024, nuk ka komunikime të tjera që e njëjta do të argumentohet vlerësimin për objektivin e parë.

Lidhur me objektivin nr. 2: *Merr pjesë në hartimin dhe miratimin e planit të prokurimit dhe pranon kërkesa për mallra, punë dhe shërbime nga departamenti përkatës ...* ankuesja është vlerësuar me nivelin e vlerësimit “*ka nevojë për përmirësim*”, mirëpo, sipas provave të lëndës, as nga ankuesja dhe as nga përgjigjja në ankesë e organit të punësimit nuk është dërguar plani objektiv dhe plani përmbushës i punës për vitin 2024, gjegjësisht as plani i prokurimit, dhe po ashtu, nuk ka ndonjë dëshmi që ankuesja nuk ka pasur bashkëpunim me departamentet përkatëse, ngase kjo nuk është argumentuar me fakte nga ana e mbikëqyrës.

Sa i përket vlerësimit të objektivit nr.5: *Kryen edhe punë tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkojnë kohë pas kohe nga mbikëqyrësi,* ankuesja është vlerësuar sipas nivelit të vlerësimit “*ka nevojë për përmirësim*”, mirëpo, sipas provave të lëndës, mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e ankueses nuk ka arritur të argumentoj me prova konkrete çfarë detyrash janë refuzuar nga ankuesja.

Kolegji i Këshillit, nga shqyrtimi i formularit të vlerësimit të punës së ankueses, konstaton se mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e ankueses në cilësinë e vlerësueses shpreh kundërthënie në vetëvlerësim e saj, sepse, në një anë tek përmbushja e objektivave pretendon se ankuesja nuk është bashkëpunues me mbikëqyrësen dhe departamentet përkatës, ndërsa në anën tjetër tek Vlerësimin i Aftësive Profesionale, gjegjësisht tek pika 1.4. Bashkëpunimi dhe puna në ekip e vlerëson me nivelin e vlerësimit *Arrin Pritshmërinë*, kurse, tek pika 1.6. Respektimi i rregullave dhe procedurave e njëjta e vlerëson me nivelin e vlerësimit *Arrin Pritshmërinë*. Vlerësime këto kundërthënëse njëra me tjetrën.

Andaj, nisur nga kjo gjendje e fakteve dhe rrethana të evidentuara si më sipër, Kolegji i Këshillit, vlerëson se vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesen nuk është bërë në raport të drejtë me provat e prezantuara dhe gjendjen e fakteve si dhe në pajtim me procedurat e parashikuara me dispozitat e nenit 52 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, andaj, në vështrim të dritës së fakteve dhe procedurave ligjore, Udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit në Komunën e Obiliqit në cilësinë e mbikëqyrësës së drejtpërdrejtë të ankueses, është e obliguar që në kuadër të arsyetimit të këtij vendimi dhe po ashtu në raport me dispozitivin e tij të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për rivlerësimin e ankueses në pajtim me dispozitat ligjore dhe gjendjen e fakteve, duke argumentuar saktësisht vlerësimin për çdo objektiv veç e veç.

Përmbledhur si më lartë, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.460/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses A.A;
- Organit të punësimit: Kryetarit të Komunës; Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit
- Arkivit të KPMSHCK-së.